



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/08/22

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. N.SH, ndaj gjyqtares I.V, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 31.01.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e papabuar ankesa e ushtruar nga av. N.SH ndaj gjyqtares I.V, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Avokati N.SH ka ushtruar ankesë ndaj gjyqtares I.V e cila është pranuar në kompetencë nga Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 19.01.2022, për inicim të procedurës disiplinore. Me datë 26.01.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës nga parashtruesi.

Parashtruesi i ankesës av. N.SH ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares Ilire Vitija për shkak të pretendimeve se, gjyqtarja në çështjen gjyqësore lidhur me lëndën C.nr.3529/19 nuk ka caktuar seancë me kohë, pra nuk ka vepruar konform dispozitës së nenit 400 të Ligjit 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, dhe me këtë, sipas parashtruesit, gjyqtari ka shkelur nenin 5 par.2 pika 2.7 të Ligjit Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në lidhje me pretendimet e palës – ushtruesit të ankesës, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se, lënda C.nr.3529/19 ka të bëjë me padi për shpërbërje dhe anulim të kontratës për shitblerjen e paluajtshmërive, e cila në gjykatë është dorëzuar me datë 08.03.2021, ndërsa nga gjyqtarja është pranuar me datë 12.03.2021, lënda në fjalë hyn në kuadër të lëndëve të reja dhe për nga natyra e saj, nuk hyn në kategorinë e lëndëve me prioritet (lëndëve që duhet të trajtohen me urgjencë). Sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit se ka dorëzuar disa urgjenca në gjykatë ndaj të cilave nuk ka marrë përgjigje, gjyqtarja e rastit ka theksuar se, gjatë ditës pranon një numër të madh të urgjencave, dhe është e pamundur t’iu përgjigjet edhe urgjencave, dhe për më tepër, sipas legjislacionit në fuqi gjyqtari nuk është i obliguar që të përgjigjet në urgjencat e palëve sepse as njëra e as tjera nuk janë të përcaktuar me dispozitat pozitive.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklaramit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares I.V.

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për shkelje disiplinore lidhur me mosveprimet e gjyqtares I.V, në lëndën në të cilën është ankuar pala. Lidhur me pretendimin e palës ankuese, se gjyqtarja e rastit ka shkelur dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për shkak të mos caktimit të seancës me kohë dhe brenda një afati të arsyeshëm, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e ushtruesit të ankesës, sepse lënda në fjalë me bazë të kontestit “anulim kontrate” i përket kategorisë së lëndëve të rregullta kontestimore që procedohen sipas radhës së pranimit të lëndëve, në pajtim me Strategjinë dhe planin e Gjykatës për kryerjen e lëndëve të vjetra dhe atyre me prioritet ligjor siç janë: Kërkesat për Urdhër Mbrojtje, lëndët për çështje statusore dhe familjare, lëndët për konteste pune, pengim posedimi etj, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/08/22, me datë 31.01.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë